




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-15103/24 datë: 18.06.2024



Npi – 01/223 datë: 24.06.2024

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 24.06.2024 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -VI- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 24.06.2024 (e hënë) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrushî, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: z.Besnik Ahmeti drejtor i DBF, z.Valon Januzi drejtor i DAP, z.Kastriot Shabani drejtor i DZHE-së, Nga zyra e informimit znj.Vlora Hyseni, znj.Gentiana Mehmeti asistente e Kryesuesit të Kuvendit dhe praktikantet znj. Valmira Hoxha, znj.Sadbere Halili.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 27.05.2024,
2. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027 (pas diskutimit publik),
3. Rishqyrtimi i Vendimit Npi-01/178 dt. 29.05.2024 sipas rekomandimit të MAPL – Nr.020-256/18-2024 dt.13.06.2024, për NPKSH 'Higjena' – Shtime,
4. Rishqyrtimi i Vendimit Npi-01/179 dt. 29.05.2024 sipas rekomandimit të MAPL – Nr.020-256/19-2024 dt.13.06.2024, për Kryqin e Kuq – Shtime.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 27.05.2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 27.05.2024.**

Pika 2

Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027 (pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ia dha Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, DBF; Përshëndetje, materialin e keni marrë edhe pse me vonesë për shkak se nuk kemi mundur me përgaditë më herët siç edhe ju e dini që diskutimet publike kanë përfunduar ditën e enjte prandaj skemi pasur mundësi ta përfundojmë me kohë, sepse është dashur që ti fusim kërkesat e qytetarëve, edhe pse kemi punuar intenzivisht. Në pika të shkurta po e lexoj dokumentin e KAB-it (shih dokumentin).

z.Kadri Emini; Përshëndetje, pa dyshim që po flasim për dokument të rëndësishëm dhe e kemi marrë sot pak me vonesë. Kështu që unë propozoj që me u shty për mbledhjen e radhës që ta përpunojmë edhe më mirë. Ky është opinionimi im personal jam i informuar se debatet publike janë mbajtur në secilin fshat. Por sot nuk mundemi me i rekomanduar Kuvendit për miratim.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, faleminderit për prezantimin pajtohem me propozimin e Kadriut është puna më e rëndësishme, ne nuk kemi çka rekomandojmë dhe propozoj që shtyhet për muajin Korrik.

znj.Adelina Beqaj; Përshëndetje, faleminderit për prezantimin, mbledhja e Korrikut nuk është larg kështu që propozoj që shtyhet për muajin Korrik.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Dëgjimet publike janë mbajtur dhe ka pasur një ftesë për të marrë pjesë në dëgjimet publike. Kanë marrë pjesë rreth 250 qytetarë gjithësejt. E keqja është se anëtarët e Kuvendit nuk kanë marrë pjesë në debate publike. Drafti i KAB-it duhet me shku i miratuar në Ministri deri me datën 28.06.2024 dhe për shkak të afatit ligjor nuk mundemi me e shty, ju ftoj që ta diskutojmë dhe ta miratojmë sepse kjo mundet me u ndryshuar në të ardhmen është vetëm dokument orientues financiar. Unë kërkoj që ky draft me u finalizuar sot, prandaj unë kisha rekomanduar që të kalojë në Kuvend dhe ti bëjmë ndryshimet që duhet bërë, dhe unë nuk jam për me u shty.

z.Besnik Ahmeti, DBF; Te kufit buxhetor nuk kemi lëvizje të kategorive ekonomike, është përafërsisht e njejt me pak ndryshime. Prandaj unë ju rekomandoj për me kalu, sepse deri më 28.06.2024 duhet me dërgu në Ministri.

z.Kadri Emini; Edhe unë po vi në pozitë të palakmueshme sepse po duhet me votu diçka pa e ditë se çka po votojmë. Duhet me u rrit presioni edhe te niveli qëndror nëse e vonojnë edhe ata. Unë e ndryshoj mendimin, por le të jetë hera e fundt që materiali me na ardhë me vonesë.

z.Përparim Ramusa; Është turpi më i madh i joni me votu diçka pa e ditë se çka po votojmë, ju e keni ditë kur është mbledhja e Kuvendit. Nuk keni punuar intenzivisht, sepse me pas punu intenzivisht e kishit prur me kohë materialin.

z.Lumni Amrushi; Unë nuk kam Liqen, para shtëpisë sime sepse aty po shkruan në dokument përreth Liqenit. Këta e kanë planin e punës të Kuvendit dhe u dasht me u organizu dëgjimet publike me kohë.

z.Kadri Emini; Nuk mundet askush me na detyru me votu asgjë. Nuk është kjo punë kaq e thjeshtë sepse ka pasë debate publike.

znj.Zejnije Veliu; Përshëndetje, unë kam marrë pjesë në disa dëgjime publike, dhe ne u kemi treguar qytetarëve se për kokë banori ka një limit të caktuar për ndarjen e mjeteve financiare, dhe prioritet kanë qenë kanalizimet, ujësjellësi etj. Procesverbalet janë të gjitha dhe mund ti shikoni. Drejtori i financave ka punuar në maksimum por ka pasë shumë kërkesa. Në debate kemi pasë mundësi me marrë pjesë të gjithë edhe si qytetarë edhe si anëtarë të Kuvendit. Materiali na ka ardhur edhe pse pak me vonesë.

znj.Adelina Beqaj; Unë kam marrë pjesë në dëgjime publike, procesverbalet po i kërkoj me mi dërguar në E-mail.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, me 3 vota "Për" (4 vota "Për" me votën e dyfishtë të Kryesuesit sipas nenit 48.1 të LVL-së Nr.03/L-040) me 3 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore Komonale 2025-2027.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; z.Përparim Ramusa, znj.Adelina Beqaj, z.Lumni Amrushi si anëtarë të PDK-së e lëshuan mbledhjen e KPF-së në ora 14:57h pa e deklaruar arsyen se pse e lëshojnë mbledhjen. Mbledhjen e lëshuan pasi u miratua rekomandimi i KPF-së për Kuvendin lidhur me KAB-in.

Pika 3

Rishqyrtimi i Vendimit Npi-01/178 dt. 29.05.2024 sipas rekomandimit të MAPL – Nr.020-256/18-2024 dt.13.06.2024, për NPKSH 'Higjena' – Shtime

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Në vazhdim Kryesuesi Konstatoi Kuorumin prej 4 anëtarëve prezent në mbledhje të KPF-së.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimsht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për ndryshimin e bazës ligjore të vendimit Npi-01/178 dt. 29.05.2024 sipas rekomandimit të MAPL – Nr.020-256/18-2024 dt.13.06.2024, për NPKSH 'Higjena'.**

Pika 4

Rishqyrtimi i Vendimit Npi-01/179 dt. 29.05.2024 sipas rekomandimit të MAPL – Nr.020-256/19-2024 dt.13.06.2024, për Kryqin e Kuq – Shtime.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Meqenëse nuk ka diskutime, Konstatohet Kuorumin prej 4 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimsht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për ndryshimin e bazës ligjore të vendimit Npi-01/179 dt. 29.05.2024 sipas rekomandimit të MAPL – Nr.020-256/19-2024 dt.13.06.2024, për Kryqin e Kuq.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Meqenëse diskutime tjera nuk kishte Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 15:06h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi

